



UDHËZUESI I MINISTRISË SË KULTURËS PËR

THIRRJEN PËR PROJEKT-PROPOZIME PËR VITIN 2017

Lexoni me vëmendje!

Fondi i Ministrisë së Kulturës për projektet do të mbështesë propozime të paraqitura nga persona fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj, që kanë në objekt të veprimtarisë së tyre promovimin dhe edukimin në fushat e artit, kulturës dhe/ose trashëgiminë kulturore jo materiale.

Ky fond shkon për projekte që zhvillohen ekskluzivisht ose kryesisht në Shqipëri. Propozim-projektet e paraqitura duhet të realizohen brenda vitit buxhetor, që do të thotë se aktivitetet e propozuara duhet të zhvillohen brenda periudhës 13 shkurt - 5 dhjetor të vitit 2017.

1. Kush mund të aplikojë?

a. Kush mund të aplikojë?

Mund të aplikojnë individë dhe organizata.

Individi përfaqëson një person fizik, që mund të jetë: artist, kurator, shkrimtar, producent, promovues i artit, kulturës, trashëgimi kulturore, si dhe të tjerë që këto fusha i kanë të përfshira në veprimtaritë e tyre.

Vini re! Subjekti duhet të paraqesë një deklaratë personale që nuk është i regjistruar si person fizik dhe si person juridik, në asnjë organ tatimor të Republikës së Shqipërisë.

Organizata përfaqëson një person juridik privat, si p.sh., shoqëri, shoqatë, fondacion etj.

Vini re! Sigurohuni pranë enteve përkatëse që subjekti juaj, të ketë status aktiv për të kryer të gjitha procedurat administrativo-ligjore dhe financiare gjatë gjithë kohëzgjatjes së projektit.

Aplikimi duhet të shoqërohet me një Vërtetim nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, se subjekti nuk ka detyrime në kontribute të Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore, tatim mbi të ardhurat nga punësimi, tatim mbi fitimin, tatimin mbi vlerën e shtuar apo lloje të tjera detyrimesh deri në muajin dhjetor të vitit aktual 2016.

A mund të aplikojë një individ ose një organizatë që nuk është subjekt i të drejtës shqiptare?

Po, por vetëm në partneritet me një subjekt të së drejtës shqiptare (qoftë ky individ ose organizatë), që duhet të jetë gjithashtu edhe aplikanti/partneri kryesor.

b. Përveç formularit të plotësuar, a duhet të paraqes dokumente të tjera?

Po. Nëse aplikoni si individ, lutemi të paraqitni një CV dhe një portofol të veprimtarisë suaj, si dhe një kopje të dokumentit tuaj të identifikimit, që mund të jetë karta e identitetit ose pasaporta.

Nëse aplikoni si organizatë, lutemi të paraqitni një CV të organizatës, një portofol të veprimtarisë së saj të deritanishme, si dhe një kopje të noterizuar të dokumentacionit që vërteton se organizata është e regjistruar pranë institucioneve përkatëse, konform legjislacionit në fuqi.

Vini re! I gjithë dokumentacioni duhet të jetë në dy kopje! Pas dorëzimit të dokumentacionit shoqërues të aplikimit nuk është e mundur të tërhiqet dokumentacioni nga arkiva e Ministrisë së Kulturës.

c. Unë jam një student/e, a mund të aplikoj?

Nuk financojmë studentët për aktivitete që lidhen me studimet e tyre ose me tarifat e studimeve të tyre.

d. Kush nuk mund të aplikojë?

Përfshihen subjektet që paraqesin projekt-propozimet që synojnë mbështetjen e aktiviteteve

kulturore të partive politike, tema diplome, masteri ose doktorature si dhe kërkime të ndryshme shkencore.

Gjithashtu, përjashtohen aplikimet nga personat juridikë publikë që përfaqësojnë institucionet dhe ndërmarrjet shtetërore, qendrore ose vendore, që vetëfinancohen ose financohen nga buxheti i shtetit ose ente të tjera publike të parashikuara me ligj.

2. Metoda e aplikimit


a. Si duhet të aplikoj?

Shkarkoni formularin për “Thirrje për projekt-propozime”, të cilin mund ta gjeni më poshtë në formatin Microsoft Word ose në formatin PDF, më pas plotësojeni atë “offline”.

- Shkarkoni Formën e Aplikimit 2017
- Shkarkoni Tabela për kostot financiare të projektit 2017
- Shkarkoni Kontrolli i plotësimit të formularit të aplikimit 2017

Formularin e plotësuar duhet ta dërgoni në adresën e e-mail-it: projekte@kultura.gov.al
Tel: 04 2223077 (orari 12.00 – 16.00). Sigurohuni që në “subject line” të e-mailit të jetë shkruar qartësisht *emri i aplikantit* dhe *titulli i projektit*, ashtu siç janë shkruar edhe në formularin e aplikimit.

Vini re! Përveç formularit të plotësuar, në këtë adresë nuk duhet të dërgoni asnjë material tjetër!



Formulari i plotësuar dhe tabela e kostove finaciare, së bashku me dokumentacionin mbështetës, përcaktuar në pikën 1/a dhe 1/b të këtij udhëzuesi, duhet të dorëzohen pranë Zyrës së Protokollit të Ministrisë së Kulturës. Këtë mund ta bëni dorazi ose nëpërmjet shërbimit postar. Adresa është e njëjtë në të dyja rastet:

Ministria e Kulturës

Rruga “Aleksander Moisiu”, nr. 76, Kutia postare 1001

ish Kinostudio “Shqipëria e Re”, Tiranë, Shqipëri.

Sipër zarfit të shkruhet qartësisht:

Drejtuar Zyrës së Protokollit:

Aplikim për projekte:

Emri i aplikantit:

Titulli i projektit:

Në raste specifike mund t’ju kërkohet informacion/dokumentacion shtesë. Nga ana tjetër, nuk do të marrim në konsideratë asnjë informacion/dokumentacion shtesë që nuk ju është kërkuar. Vini re se në rastin kur aplikuesi është një organizatë, formulari i aplikimit dhe tabela e kostove finaciare duhet të mbajë firmën e përfaqësuesit ligjor dhe vulën e organizatës.

b. Kur mund të aplikoj?

Thirrja për projekt-propozime e Ministrisë së Kulturës për vitin 2017 fillon ditën e enjte, data 1 dhjetor 2016, dhe mbyllet ditën e premte, data 13 janar 2017, në orën 12.00.

Vini re! Nuk do të pranohet asnjë aplikim që vjen pas këtij orari!

c. Kur mund të fillojë projekti që kam propozuar dhe kur duhet të mbarojë?

Kur të caktoni datën në të cilën fillon aktiviteti juaj, mos harroni të merrni parasysh jo vetëm kohëzgjatjen e “Thirrjes për projekt-propozime”, por edhe kohëzgjatjen e procesit të vlerësimit të projekt-propozimeve të paraqitura, si dhe periudhën midis shpalljes së fituesve dhe lidhjes së kontratës midis tyre dhe Ministrisë së Kulturës. Gjithashtu, projektet e propozuara duhet të përfundojnë brenda vitit buxhetor 2017.

Për këtë thirrje, projektet e propozuara nuk mund të fillojnë më herët se data 13 shkurt 2017.

d. Sa zgjat procesi i vlerësimit?

Përzgjedhja përfundimtare shpallet nga kolegjiumi në datën 6 shkurt 2017.

e. Cila është shuma për të cilën mund të aplikoj?

Shuma për të cilën një individ mund të aplikojë shkon nga 100,000 deri në 500,000 lekë. Shuma për të cilën një organizatë mund të aplikojë shkon nga 100,000 deri në 2,000,000 lekë.

f. Kam nevojë për fonde nga partnerë dhe/ose donatorë të tjerë?

Po, të paktën 15 % të fondeve që ju duhen për aktivitetin tuaj duhet t'i siguronit nga burime të tjera. Këto mund të përfshijnë fonde nga organe publike, mbështetje në natyrë, grante nga fondacione, një kontribut nga vetë ju ose organizata juaj etj. Partnerët dhe donatorët e tjerë duhet të deklarohen dhe të vërtetohen me dokument ligjor.

g. A mund të aplikoj për më tepër se një projekt gjatë të njëjtës fazë të “Thirrjes për projekt-propozime”?

- Nuk mund të aplikoni për më tepër se një projekt gjatë “Thirrjes për projekt-propozime” për vitin 2017.
- Nuk mund të aplikoni nëse nuk janë mbyllur procedurat në lidhje me një projekt të mëparshëm tuajin të financuar ose mbështetur nga MK.
- Nuk mund të aplikoni nëse projekti që jeni mbështetur gjatë vitit 2016, i shtrin efektet e realizimit të plotë edhe përgjatë vitit 2017.
- Nuk mund të aplikojnë subjekte që kanë detyrime të pashlyera të ngarkuara nga KLSH, Tatimet, apo ente të tjera shtetërore.

h. Ku mund të kërkoj ndihmë në lidhje me aplikimin tim?

Për informacione të përgjithshme, kontaktoni në:

E- mail : info_projekte@kultura.gov.al

Tel: 04 2223077 (orari 12.00 - 16.00)

3. Për çfarë mund të aplikoj?

a. Për çfarë lloj aktivitete mund të aplikoj?

Financohen dhe mbështeten aktivitete kulturore që përfshijnë: projekte dhe evente; prodhime kulturore dhe letrare artistike; hulumtim, zhvillim dhe zgjerim të audiencave; aktivitete promovuese dhe edukuese nëpërmjet artit, kulturës dhe trashëgimisë kulturore jo materiale; ngritje kapaciteti të organizatave artistike e kulturore; projekte artistike e kulturore shëtitëse.

Vini re! Fushat e Aplikimit dhe rastet e përjashtimit

Në fushën e Kinematografisë: mbështeten projekte promovimi dhe edukimi përmes kinemasë (festivale, promovim filmi, edukim të audiencave përmes kinemasë), por përjashtohen

produksione të veprës filmike, në të treja gjinitë e filmit (artistik, dokumentar dhe të animuar) sipas përcaktimeve të bëra në ligjin nr. 9353, datë 3.3.2005 “*Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8096, dt 21.03.1996 “Për Kinematografinë”*”

Në fushën e Trashëgimisë Kulturore Jomateriale: mbështeten projekte promovimi dhe edukimi përmes trashëgimisë kulturore dhe diversitet kulturor, por përjashtohen projektet që kanë natyrë rehabilituese apo restauruese.

Në fushën e Librit: mbështeten projektet e promovimit të librit dhe edukimit të leximit, por përjashtohen përkthime letrare dhe krijime letrare, të cilat do të trajtohen në thirrje dhe fonde të veçanta.

b. Si do të vlerësohen kërkesat për financim dhe/ose mbështetje për projekte pranë Ministrisë së Kulturës?

Çdo propozim kalon nëpër dy faza të vlerësimit:

- vlerësimi i individit/organizatës;
- vlerësimi i projekt-propozimit (formulari i propozimit dhe tabelës së kostove).

Në procesin e vlerësimit të individit/organizatës që paraqet kërkesën do të merren parasysh: Profili dhe reputacioni i individit/organizatës dhe kapaciteti zbatues/menaxhues i tij/saj; theksojmë se kriteret e mëposhtme nuk duhet të dekurajojnë organizata të reja, të cilat mund të përmbushin kriteret e tjera;

- veprimtaria e deritanishme dëshmon se individ/organizata ka në objekt të veprimtarisë së tij/saj artin, kulturën dhe/ose trashëgiminë kulturore;
- misioni i organizatës dhe objektivat e veprimtarisë së saj të deritanishme përputhen me politikat dhe strategjitë e Ministrisë së Kulturës;
- individ/organizata ka përvoja të suksesshme me partnerë e donatorë të tjerë;
- organizata ka treguar qëndrueshmëri dhe është rritur me kalimin e viteve;
- individ/organizata ka kontribuar në fushën ku operon me produkte të rëndësishme;
- individ/organizata ka kapacitetin në terma të burimeve njerëzore dhe ekspertizën teknike për të zbatuar/menaxhuar projektin;
- Individ ka patur korrektësi në marrëdhënie kontraktuale me Institucionin e Ministrisë së Kulturës.

Në procesin e vlerësimit të projekt-propozimit do të merren parasysh pikat e mëposhtme:

- Propozimet që kanë në objekt të veprimtarisë së tyre artin, kulturën dhe trashëgiminë jomateriale;
- objektivat e projektit të propozuar përputhen me politikat dhe strategjitë e Ministrisë së Kulturës;
- objektivat e projektit të propozuar përputhen me problematikën e identifikuar;
- origjinaliteti i projektit dhe cilësia e aktiviteteve të planifikuara;
- aktivitetet e planifikuara përputhen me objektivat e projektit, hapat e zbatimit të projektit janë të qarta;
- shpërndarja e burimeve dhe bashkërendimi i punës midis partnerëve janë efikase;
- treguesit e përzgjedhur për matjen e rezultateve të aktiviteteve të planifikuara janë të përshtatshëm;
- përpilimi i kostove financiare: kostot të jenë reale (çmimet të jenë të bazuara në referenca dhe të detajuara, ku aplikanti duhet t'i argumentojë dhe t'i justifikojë;
- niveli i bashkëpunimit me individë/organizata të tjera, si dhe bashkëfinancimi i projektit/kontribute nga palë të treta;
- qëndrueshmëria e projektit: sa afatgjatë është impakti i projekt-propozimit; nëse projekt-propozimi paraqet mundësi për rritjen profesionale të individit/ngritjen e kapaciteteve të organizatës që aplikon, realizimin e projekteve të tjera në të njëjtën fushë ose adresimin e të njëjtës problematikë, zhvillimin e skenës artistike e kulturore në Shqipëri;
- respektimi i të drejtës së autorit në të gjitha fazat – konceptim, hartim dhe zbatim të projektit të propozuar, sipas përcaktimeve të bëra në ligjin Nr.9380, datë 28.4.2005 “*Për të drejtën e Autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të*”, i ndryshuar.

Procesi i vlerësimit do të kryhet nga kolegji i ngritur posaçërisht për këtë qëllim, i përbërë nga nëpunës të nivelit të mesëm dhe të lartë, si dhe drejtues të strukturave përgjegjëse që mbulojnë secilën nga gjinitë e artit, kulturës apo trashëgimisë jomateriale.

d. Si duhet të veproj pasi kërkesa ime pranohet?

Nëse kërkesa juaj pranohet, ju do të kontaktoheni nga Ministria e Kulturës për të proceduar me lidhjen e kontratës. Me lidhjen e marrëdhies kontraktuale dhe fillimin e projektit do të fillojë gjithashtu edhe procesi i monitorimit nga ana e Ministrisë së Kulturës.